Pa. nr: 08-131

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Jozheta Mirtiça nr. 9, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Qoku dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 14.10.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi, me të cilin PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Jozheta Mirtiça nr. 9, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o., me seli të regjistruar në adresën rruga Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie në fushëveprimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve në treg, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000,00 denarësh dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarësh, sipas tarifës nr. 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), më datë 09.09.2026, ndërsa i plotësuar më datë 17.09.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Jozheta Mirtiça nr. 9, 1000

Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, me të cilin PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o. dhe SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese d.o.o., do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o., me seli të regjistruar në adresën rruga Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për Përqendrim, plotësimit të tij dhe shtojcave përkatëse, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., është e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Sllovenisë për ushtrimin e veprimtarisë së fondeve investuese në tregjet monetare dhe jomonetare. Fondi kryesisht investon në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ndërsa në vitin 2025 ka realizuar investim në shoqërinë sllovene Kukinox d.o.o., e cila është e angazhuar në prodhimin dhe shitjen e pajisjeve të hotelerisë.

PRVA CAP d.o.o., Fondi Special i Investimeve, k.d., është pjesë e Grupit më të gjerë PRVA.

PRVA CAP menaxhohet nga PRVA CAP, menaxhimi i investimeve, d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, e cila ushtron veprimtarinë e menaxhimit të fondeve alternative të investimeve, në përputhje me Ligjin slloven për Menaxherët e Fondeve Alternative të Investimeve.

PRVA CAP d.o.o. aktualisht menaxhon një fond alternativ investimi për kapital privat, me emërtimin Fondi PRVA CAP, i cili është organizuar në formën e një shoqërie komandite të veçantë. PRVA CAP d.o.o. nuk ka investime të tjera dhe as shoqëri të varura. PRVA CAP d.o.o. është e regjistruar për ushtrimin e veprimtarive të tjera të shërbimeve financiare, përveç sigurimit dhe financimit pensional.

Grupacioni PRVA është i pranishëm dhe realizon të hyra në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet dy shoqërive të varura si vijon:

-KB Prvo Shoqëria Pensionale SHA Shkup, me seli të regjistruar në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, 1000 Shkup, e regjistruar me numër regjistrimi 5990815, me veprimtari prioritare të regjistruar menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, duke përfshirë edhe menaxhimin e mjeteve të fondeve, përfaqësimin para personave të tretë dhe veprimtari të tjera që lidhen me menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale; dhe

-PRVA Zhivot SHA Shkup, me seli të regjistruar në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6/1-2, 1000 Shkup, e regjistruar me numër regjistrimi 7687826, me veprimtari prioritare të regjistruar sigurimin e jetës. PRVA Zhivot është shoqëri për sigurimin e jetës, e cila ofron produkte për sigurimin e jetës për mbulimin e rrezikut, si dhe sigurimin e jetës të lidhur me investime.

AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o., është shoqëri holding, e cila merret me zotërimin dhe menaxhimin e pjesëve në dy shoqëritë e mëposhtme:

-ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o.; dhe

-iTimeExtend, zgjidhje informatike d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Jozhe Mirtiça nr. 9, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

AORTA HOLDING, veprimtari investuese d.o.o., përfshirë ASCALAB dhe iTimeExtend, nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese d.o.o., vepron në fushën e sigurisë së informacionit dhe shërbimeve të tjera nga fusha e teknologjisë informatike.

SMART DATA SECURITY ADRIATIC nuk është e pranishme dhe nuk realizon asnjë të hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o., është e angazhuar në ofrimin e shërbimeve të programimit kompjuterik, kryesisht në zhvillimin e softuerëve me porosi për bizneset (B2B), zhvillimin e aplikacioneve mobile dhe shërbimeve të integrimit të sistemeve në sektorë të ndryshëm, si dhe në ofrimin e shërbimeve që lidhen me migrimin në cloud (re kompjuterike), DevOps dhe UI/UX.

ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o., ka vetëm një degë, ASCALAB – Dega Nish, me seli të regjistruar në rr. Proletna nr. 6, Donja Vrezhina, Pantelej, Republika e Serbisë. Dega është tërësisht e varur nga ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o. dhe nuk përbën person juridik të veçantë.

ASCALAB, zgjidhje informatike dhe zhvillim d.o.o., nuk është e pranishme dhe nuk realizon asnjë të hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,* vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:
Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ